



Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 12 Tetor 2019

## **KALLZIM PENAL**

**KALLZUES:** Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqesuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Gazment BARDHI.

**KUNDER:** Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë

Shefit të Komisarariatit të Policisë së Shtetit nr. 6, Tiranë

**Punonjësve të Policisë së Shtetit që janë angazhuar në aksionin policor të dhunimit flagrant të Banorëve të Unazës së Re në datën 11 Tetor 2019**

**OBJEKTI:**

1. Fillimin e procedimit penal për kryerjen e veprës penale të parashikuara në neni 248 “Shpërdorimit të detyrës”, neni 250 “Kryerja e veprimeve arbitrare”, neni 251 “Mosmarrja e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme”, dhe neni 261 “Pengimi në ushtrimin e të drejtës për t’u shprehur, grumbulluar apo manifestuar”, të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

2. Marrjen e masës së sigurimit personal ndaj të Kallëzuarve “Të pezullimit të ushtrimit të detyrës publike”, të parashikuar nga neni 242 i K.Pr.Penale.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 248, 250 dhe 251 të K.Penal. Nenet 242, 280 dhe 281 i K.Pr.Penale;

**DREJTUAR:** PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË

E nderuar zonja Drejtuese e Prokurorisë,

Më datë 10 Tetor 2019, një grup banorësh të Unazës së Re, kanë njoftuar Komisariatin e Policisë së Shtetit nr. 6, në Tiranë, për organizimin e një tubimi urgjent për në datën 11 Tetor 2019, ora 18.30-19.30. Qëllimi i protestës ka qenë kundërshtimi i një projekti që cenon të drejtën e pronësisë së banorëve dhe që prej tyre është vlerësuar si korruptiv dhe klientelist, fakt që ka rezultuar më vonë edhe i provuar nga denoncimet në media.

Dorëzimi i njoftimit është kryer publikisht në prezencë të medias dhe është transmetuar live nga disa prej tyre.

Sipas njoftimit, banorët e Unazës së Re kanë zhvilluar protestën e tyre paqësore dhe pa asnjë akt dhune. Në përfundim të protestës, një numër i konsiderueshëm punonjësish policia, disa prej tyre të paidentifikuar dhe të veshur civil, kanë filluar një aksion të paligjshëm policor, duke shoqëruar dhe më pas arrestuar me dhjetra qytetarë.

Disa prej qytetarëve që i është hequr liria, rezulton se kanë qenë thjeshtë kalimtar në zonën ku ishte zhvilluar protesta. Disa të tjerë kanë qenë pjesëmarrë në atë proteste. Qytetarët pa asnjë shkak janë shoqëruar për në ambientet e Komisariatit nr. 6 Tiranë dhe në Drejtorinë e Qarkut Tiranë.

Ndërkohë, punonjës të medias, sicc është rasti i operatorit të Televizionit Shijak TV, në krye të detyrës janë penguar të filmojnë dhe informojnë mbi situatën e krijuar nga Policia e Shtetit. Operatori i Shijak TV Ledio Guni, pasi është ndaluar të filmonte, është marrë me forcë nga punonjës të policisë dhe është shoqëruar në Komisariatin nr. 6 Tiranë. Nga raportimet e parë rezulton se ai është dhunuar gjatë dhe pas shoqërimit në Polici.

Edhe mirëmbajtësi i adresës zyrtare të facebook të Partisë Demokratike, që ka qenë në krye të detyrës, duke filmuar dhe transmetuar live çfarë po ndodhte, është dhunuar dhe penguar nga Policia e Shtetit, i është marrë me dhunë aparati celular me të cilin po regjistronte dhe i janë fshirë të gjitha filmimet që kishte kryer, në kuadër të informimit të qytetarëve mbi situatën.

Të gjitha veprimet e mësipërme janë të paligjshme dhe kriminale, si dhe përbëjnë vepër penale, të kryer nga punonjës të Policisë së Shtetit.

Konkretisht, veprat penale të konsumuara në këtë rast janë si më poshtë:

**Neni 248 “Shpërdorimi i detyrës”:** *Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet.*

**Neni 250 “Kryerja e veprimeve arbitrare”:** *Kryerja e veprimeve ose dhënia e urdhrave arbitrare, nga ana e punonjësit që kryen një funksion shtetëror ose një shërbim publik gjatë ushtrimit të detyrës së tij, të cilat prekin lirinë e shtetasve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.*

**Neni 251 “Mosmarrja e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme”:** *Mosmarrja e masave ose moskërkimi pranë personit kompetent, që të ndërpritet gjendja e paligjshmërisë si rezultat i një veprimi arbitrar, që ka prekur lirinë e shtetasit, nga ana e personit të ngarkuar me një funksion shtetëror ose në shërbim publik, që vjen në dijeni të asaj gjendjeje për shkak të funksionit apo shërbimit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.*

**Neni 261 “Pengimi në ushtrimin e të drejtës për t’u shprehur, grumbulluar apo manifestuar”:** *Kryerja e veprimeve për të penguar shtetasit për të ushtruar lirinë e shprehjes së mendimit, të grumbullimit apo manifestimit, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj. Kur veprimet shoqërohen me përdorimin e dhunës fizike, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.*

Punonjësit e Policisë së Shtetit, duke vepruar në kundërshtim me ligjin, jo vetëm kanë kryer veprime apo mosveprime të paligjshme, që kanë prekur interesat e shtetasve, por nga ana tjetër, me veprimet e tyre arbitrare, kanë cënuar lirinë e qytetarëve dhe kanë synuar t’i intimidojnë dhe pengojnë në ushtrimin e të drejtës së tyre kushtetuese për të protestuar, paqësisht dhe pa armë.

Në Kreun IV “DETYRAT E POLICISË SË SHTETIT” neni 17 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” nën titullin “Detyrat” parashikohet shprehimisht: “1. Detyrat e Policisë së Shtetit janë: a) mbron jetën, shëndetin, pronën publike

dhe private; b) ruan rendin dhe sigurinë publike; c) parandalon, zbulon dhe heton, në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal, veprat penale dhe autorët e dyshuar të kryerjes së tyre; ç) organizon fushata ndërgjegjësuese dhe informuese, me qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale, si dhe rritjen e bashkëpunimit me publikun;”.

Ndërsa në KREUN XIV “MASAT PËR RUAJTJEN E RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE”, neni 101 nën titullin “Masat për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike”, parashikohet shprehimisht se: “1. Kur sjellja e personit cenon rendin dhe sigurinë publike, punonjësi i policisë, në zbatim të përgjegjësive të tij dhe në përputhje me ligjin: a) merr masa për shmangien e rrezikut për shtetasin dhe veten; b) vlerëson nëse është e nevojshme marrja e masave shtesë ose dhënia e ndihmës dhe njofton menjëherë autoritetet përgjegjëse administrative. 2. Nëse cenimi i rendit dhe sigurisë publike ka ardhur si pasojë e veprimeve të një personi të mitur nën 14 vjeç, punonjësi i policisë merr masa për të ndërprerë veprimet e paligjshme dhe njofton prindin ose kujdestarin e të miturit. 3. Në rastet kur fëmija nuk ka prind apo kujdestar, punonjësi i policisë vë në dijeni Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe organizatat e shoqërisë civile për të drejtat e fëmijëve.”.

Më tej në nenin 109 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” nën titullin “Shoqërimi në polici” parashikohet shprehimisht se: “1. Punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në ambientet e Policisë ose institucionin urdhërdhënës në kushtet dhe rastet e mëposhtme: a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente; b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose ndonjë detyrimi të përcaktuar me ligj; c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer vepra penale; ç) për të parandaluar kryerjen e një veprave penale; d) kur është larguar pas kryerjes së një veprave penale; dh) për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, sipas kushteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale; e) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose shoqërimin e tij në organin kompetent; ë) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë; f) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose ekstradimit. 2. Personi i shoqëruar nuk trajtohet në të njëjtat kushte me personin e ndaluar ose të arrestuar dhe, në çdo rast, shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë.”.

Nga ana tjetër, nenet 5, 17, 85, 86, 102 dhe 133 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, parashikojnë parimet dhe standardet e sjelles së Policisë së Shtetit.

Në nenin 5 të ligjit për Policinë e Shtetit, parashikohet shprehimisht se: *“Parimet bazë, në bazë të të cilave udhëhiqet Policia e Shtetit në veprimtarinë e saj, janë: a) ligjshmëria; b) mosdiskriminimi; c) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; ç) proporcionaliteti; d) pavarësia operationale; dh) paanshmëria politike; e) integriteti, merita dhe profesionalizmi.*

Nga ana tjetër, sipas nenit 85 të ligjit, *“punonjësi i policisë detyrohet të respektojë Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si dhe të mbrojë të drejtat e liritë e njeriut. Punonjësi i policisë mban përgjegjësi individuale për ligjshmërinë e çdo veprimi apo mosveprimi të tij gjatë ushtrimit të detyrës. Punonjësi i policisë kryen me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim dhe në përputhje me ligjin detyrat e tij”. Ndërkohë që neni 86, parashikon se: “1. Punonjësi i policisë ka detyrimin të zbatojë të gjithë urdhrat e ligjshëm që jepen nga një punonjës më i lartë në funksion ose në gradë. 2. Punonjësi i policisë, nëse ka arsye të dyshojë se urdhri i dhënë është i paligjshëm, ai menjëherë ia bën të ditur eprorit dhe, kur është e mundur, kërkon me shkrim që urdhri të jepet me shkrim. Në çdo rast, kur ka kërkesë verbale apo me shkresë për dhënien e urdhrimit me shkrim, eprori është i detyruar të procedojë sipas kërkesës me shkrim. 4. Kur një punonjës policie, edhe pas zbatimit të procedurave të përcaktuara në këtë nen, vazhdon të ketë arsye për të dyshuar se urdhri është i paligjshëm, ai kryen veprimet e mëposhtme: a) kundërshton urdhrin, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 3, të këtij neni; b) vë menjëherë në dijeni punonjësin e policisë, i cili është drejtpërdrejt në një funksion më të lartë sesa eprori që ka dhënë urdhrin, si dhe për masat e marra prej tij në zbatim të këtij neni.”.*

Po të vihet re, janë pikërisht të gjithë këto nene në legjislacionin bazë për Policinë e Shtetit që detyrojnë efektivet e policisë për të ndërmarrë një sërë veprimesh që të jenë në proporcionalitet me shkallën e rrezikut dhe jo të përdorin forcën në kundërshtim me nenet 102 dhe 133 të sipërcituar.

Në po të njëjtën mënyrë fryma e ligjit është zbërthyer edhe në Rregulloren e Policisë së Shtetit të miratuar me VKM Nr. 750, datë 16.9.2015 “Për miratimin e rregullores së Policisë së Shtetit”, më konkretisht në nenet 106, 107, 108, 109, 110 dhe 111. Punonjësit e Policisë së Shtetit i kanë shkelur të gjitha këto

parime të veprimtarisë së tyre me veprimet e ndërmarra në nderhyrjen brutale të datës 11.10.2019.

Kjo për faktin se banorët e shoqëruar, kanë qenë ose pjesëmarrës në një tubim të ligjshëm ose kalimtar të rastit në zonën ku zhvillohej tubimi. Ndërkohë që punonjësit e medias apo punonjësi i Partisë Demokratike të Shqipërisë, kanë qenë në krye të detyrës së tyre për informimin e opinionin publik mbi situatën.

E drejta për protestë është një e drejtë themelore e njeriut, që gëzon mbrojtje të posacme nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Në nenin 15 të Kushtetutës thuhet shprehimisht se: *"1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. 2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre."*. Në kreun e III-të të Kushtetutës janë parashikuar **"LIRITË DHE TË DREJTAT POLITIKE"**. Kështu, në nenin 46 pika 1 të Kushtetutës parashikohet shprehimisht se: *"Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm"*, ndërsa në nenin 47 të saj parashikohet se: *"Liria e tubimeve paqësore dhe pa armë, si dhe pjesëmarrja në to është e garantuar. Tubimet paqësore në sheshe dhe në vende të kalimit publik bëhen sipas procedurave të parashikuara me ligj"*.

Nga interpretimi logjik dhe sistematik i këtyre dispozitave, arrihet në përfundimin se liria e tubimit paqësore dhe pa armë është e garantuar, për rrjedhojë organet e pushtetit publik jo vetëm që duhet të respektojnë këtë liri por kanë dhe detyrimin për të kontinuar në realizimin e saj. Ndërkohë për tubimet paqësore në sheshe dhe në vende të kalimit publik, Kushtetuta parashikon rezervën ligjore, duke i deleguar ligjvënësit për të përcaktuar procedurat e realizimit të saj.

E drejta kushtetuese për të tubuar, në një shtet demokratik, merr një rëndësi të veçantë. E drejta për t'u tubuar lirisht dhe pa ndonjë leje të veçantë me të tjerë, ka qenë gjithnjë e vlefshme si shenjë e lirisë, pavarësisë dhe fjalës së lirë të qytetarit të përgjegjshëm. Garantimi i lirisë për aktivitetet politike në të njëjtën kohë edhe një vendim, i cili shtrihet përtej mbrojtjes së shpalosjes së personalitetit nga ndërhyrjet shtetërore. Kushtetuta garanton si të drejtë mbrojtëse, për mbartësit e së drejtës, e cila u shërben mbi të gjitha pakicave që mendojnë ndryshe të drejtën për të vendosur vetë për vendin, orën, llojin

dhe tematikën e tubimit dhe, në të njëjtën kohë, ndalon forcën e shtetit për të marrë pjesë apo për t'i ndenjtur larg një tubimi.

Liria e shprehjes konsiderohet si një nga elementët kyç e të domosdoshëm të një shteti demokratik. Ajo është shprehje direkte e personalitetit njerëzor dhe një nga vlerat kushtetuese më fisnike, e cila është në themel të një rendi të lirë e demokratik, sepse ajo mundëson debatin e vazhdueshëm dhe luftën e mendimeve si element të qenësishëm të kësaj forme shtetërore. Kuptimi i vërtetë i lirisë së tubimit del në pah, kur merret parasysh veçantia e procesit të formimit të vullnetit në një sistem demokratik. Tubimet me të drejtë përcaktohen si element i qenësishëm i tolerancës demokratike. “Ato ofrojnë mundësinë për të ndikuar procesin politik, për të zhvilluar iniciativa dhe alternativa pluraliste ose edhe kritikë apo protestë...” ato përmbajnë një copëz të demokracisë fillestare të drejtpërdrejtë, e cila është e përshtatshme që të mënjanojë rrezikun e reduktimit të politikës vetëm në rutinë administrative.

Liria e tubimit është një element bazë dhe i domosdoshëm i funksionimit të demokracive parlamentare dhe me të drejta të kufizuara bashkëveprimi. Protesta demonstrative bëhet veçanërisht e nevojshme, nëse organet përfaqësuese nuk identifikojnë në kohë probleme dhe vështirësi potenciale apo i pranojnë ato për interesa të caktuara. Në literaturë përshkruhet me saktësi funksioni stabilizues i lirisë së tubimit për sistemin përfaqësues. Liria e tubimit lejon që të shfaqet publikisht pakënaqësia, indinjata dhe kritika, çka shërben si një sistem alarmi politik, i cili tregon çfarë nuk shkon, nxjerr në pah deficitet e përfshirjes dhe, në këtë mënyrë, i jep mundësi politikës që të korrigjojë kursin e saj.

Kushtetuta merr në konsideratë se ushtrimi i lirisë së tubimit në mjedise të hapura, për shkak të kontaktit me botën e jashtme, ka nevojë të rregullohet me ligj, lidhur me anën organizative dhe procedurale, në mënyrë që nga njëra anë të krijohen kushte për ushtrimin e kësaj lirie, dhe nga ana tjetër, të mbrohen interesat e të tretëve që bien ndesh me këtë liri. Domosdoshmëria për kufizimin e lirisë së tubimit mund të rezultojë, nëse një demonstrant, gjatë ushtrimit të kësaj të drejte cenon të drejtat e të tretëve. Edhe në çënime të tilla, organet shtetërore duhet t'i interpretojnë ligjet që kufizojnë të drejtat kushtetuese. Me këto kërkesa do të ishin të papajtueshme masat shtetërore, që kapërcejnë implementimin e ligjeve për kufizimin e të drejtave dhe të cilat p.sh pengojnë pjesëmarrjen në demonstrata duke vënë postobllloqe dhe duke

bërë kontrole të gjata për masa sigurie ose lejojnë që shteti të ndërhyjë në to, apo duke mbikëqyrur apo regjistruar pjesëmarrësit.

Detyrimi për njoftimin e tubimit, në shumicën e rasteve, e kufizon të drejtën kushtetuese në mënyrë të pakonsiderueshme. Duhet pranuar se dispozita ligjore e detyrimit për të njoftuar tubimin, nuk vlen për çdo rast dhe se cënimi i saj nuk jep të drejtën automatike për të shpërndarë apo ndaluar një aktivitet. Njoftimi vlen vetëm për tubimet në qiell të hapur, sepse për shkak të ndikimit të jashtëm të shumëfishtë që kanë, për to duhet të merren masa parandaluese të veçanta. Të dhënat që lidhen me njoftimin duhet t'u japin informacionin e nevojshëm autoriteteve, në mënyrë që ato të mund të parashikojnë nga njëra anë se ç'masa duhen marrë lidhur me trafikun rrugor apo me çështje të tjera që tubimi të zhvillohet pa probleme dhe nga ana tjetër, çfarë do të ishte në interes të të tretëve, si edhe në interes të shoqërisë, për më tepër, se si mund të koordinohen këto me njëra tjetrën. Pikëpamja më e pranuar është se nuk është e detyrueshme për të njoftuar paraprakisht demonstratat spontane, të cilat organizohen duke marrë shkas nga një zhvillim i momentit. Nëse njoftimi i tubimit nuk është i detyrueshëm në çdo rast dhe mosbërja e tij nuk do të thotë që demonstrata automatikisht të shpërndahet apo të ndalohet, atëherë nuk del në pah, se detyra që rezulton nga preokupimi për të mirën e përgjithshme zakonisht do të ishte joproporcionale.

Shqetësimet që mund të rezultojnë nga masiviteti i ushtrimit të kësaj së drejte dhe që nuk mund të shmangen pa ndikuar tek qëllimi i aktivitetit në përgjithësi, duhet të tolerohen nga të tretët. Nuk duhet të merren parasysh arsye teknike të qarkullimit rrugor për ndalimin e tubimeve, sepse është e mundur të arrihet përdorimi i rrugëve paralele nga demonstruesit dhe mjetet e qarkullimit rrugor. Kompetenca e ndërhyrjes së autoriteteve kufizohet nga fakti që ndalimi dhe shpërndarja e tubimeve janë të ligjshme vetëm në rastin e një "rreziku për sigurinë ose rendin publik drejtpërdrejtë". Kjo kërkesë i bën kriteret e ndërhyrjes më strikte sesa në praktikën e zakonshme operative të policisë. Në rastin konkret është i nevojshëm një parashikim i rrezikut. Diçka e tillë përgjithësisht ka të bëjë me një vlerësim të mundshëm dhe duhet të provohet se ku bazohet ai. Për sa i përket kësaj jurisprudenca parashikon që të marrë për bazë "rrethana të dukshme", pra fakte, kontekste dhe hollësi të tjera thjesht hamendësimet apo dyshimet nuk mjaftojnë.

Në nenin 17 të Kushtetutës parashikohet shprehimisht se: *"1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen*



*vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.”.*

Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se kufizimet e vendosura ndaj të drejtave dhe lirive themelore sikurse është dhe liria e tubimit nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim KEDNJ) e interpretuar nëpërmjet Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Lidhur me fuqinë juridike të vendimeve të GJEDNJ-së në sistemin tonë juridik, duhet t'i referohemi jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, e cila në vendimin Nr. 20, datë 01.06.201124 ndër të tjera ka theksuar se: *“Gjykata, në vijim të argumenteve të saj, e sheh me vend të theksoje se, për trajtimin e të drejtave themelore të njeriut, GJEDNJ-ja ka në sistemin tonë juridik një kompetencë ekskluzive. Kjo kompetencë është e pranuar nga sistemi ynë i brendshëm juridik, për efekt të zbatimit të nenit 122 të Kushtetutës, po edhe të nenit 17/2 të saj, të cilët sjellin si detyrim që vendimet e GJEDNJ-së të zbatohen drejtpërsëdrejti. Me rastin e ratifikimit të KEDNJ-së Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si përfaqësues i sovranitetit popullor, ka marrë përsipër detyrime të cilat janë të zbatueshme nga të gjitha organet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, përfshirë gjykatat e të gjitha niveleve, pavarësisht llojit të tyre. Për sa më sipër, detyrimet që mbartin secili nga pushtetet për zbatimin e vendimeve përfundimtare të GJEDNJ-së janë të ndryshme. Nëse për ekzekutivin janë menjëherë të ravigjueshme këto detyrime, si p.sh. në rastin e pagimit të dëmshpërblimeve të imponuara nga GJEDNJ-ja, për sa i përket dy pushteteve të tjera ka vend për interpretim. Posaçërisht për sa i përket vendimeve të GJEDNJ-së për procedime penale, për legjislativin lind nevoja që të marrë masa për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me dispozitat e KEDNJ-së. Nëse nuk ka harmonizim pra, nëse jemi në rastet e vakumit legjislativ, ose kur parashikimet ligjore bien në kundërshtim me dispozitat e Konventës, atëherë gjyqtarët e çdo niveli zbatojnë drejtpërsëdrejti vendimet e GJEDNJ-së në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës dhe nenet 19 dhe 46 të KEDNJ-së. Neni 122 I Kushtetutës përcakton shprehimisht se dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare kane epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.”*, ndërsa në vendimin Nr. 45, datë 01.11.2013 Gjykata Kushtetuese lidhur me fuqinë juridike të GJEDNJ-së ndër të tjera ka theksuar se: *“10. Vendimet e GJEDNJ-së kanë vlerën e tyre në dy aspekte, që lidhen me natyrën detyruese, që rrjedh nga nenet 1 dhe 46 të*

Konventës, dhe me mënyrën e zbatimit të tyre në sistemin e brendshëm. GJEDNJ-ja ka sqaruar parimet që rregullojnë zbatimin e vendimeve të saj, duke i vënë theksin zbatimit efektiv të këtyre vendimeve (vendimi në çështjen Verein Gegen Tierfabriken Schœeiz (VgT) kundër Zvicrës (nr. 2), datë 30.06.2009). Sipas kërkesave të nenit 46 të KEDNJ-së, një shtet palë për të cilin GJEDNJ-ja është shprehur se ka shkelur Konventën ose Protokollet e saj, ka detyrimin që të veprojë në përputhje me vendimin e asaj Gjykate. Me fjalë të tjera, një dështim tërësor ose i pjesshëm i ekzekutimit të vendimit të GJEDNJ-së lind përgjegjësinë ndërkombëtare të shtetit. Shteti në fjalë ka detyrimin jo vetëm të shlyejë dëmin material ndaj personave të interesuar, por edhe të marrë masa individuale dhe/ose, nëse është e përshtatshme, masa të përgjithshme në rendin e vet ligjor, që t'i japë fund shkeljes së gjetur nga Gjykata dhe të rregullojë pasojat e shkeljes, me qëllimin që kërkuesi të rikthehet, për aq sa është e mundur, në gjendjen që ishte para se të bëhej shkelja (vendimi në çështjen Scozzari dhe Giunta kundër Italisë, nr. 39221/98 dhe 41963/98, § 249, ECHR 2000-VIII, dhe Assanidze kundër Gjeorgjisë, nr. 71503/01, § 198, ECHR 2004-II). Në vendimet e saj GJEDNJ-ja ka shprehur parimin e njohur të së drejtës ndërkombëtare *restitutio in integrum*, i cili është përdorur shpesh nga Komiteti i Ministrave në rezolutat e tij. Edhe pse në lidhje me mënyrën se si do të zbatohen detyrimet e parashikuara në nenin 46 të Konventës për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së, shtetet palë të Konventës gëzojnë diskrecion dhe Konventa nuk përmban dispozita që t'u imponojë Palëve Kontraktuese detyrimin për të parashikuar në ligjin e brendshëm rishqyrtimin apo rihapjen e procedimeve, ekzistenca e mundësive të tilla, në rrethana të veçanta, ka provuar të jetë e rëndësishme dhe, në disa raste, i vetmi mjet për të arritur *restitutio in integrum*.”.

Në nenin 11 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (Liria e tubimit dhe e organizimit), parashikohet shprehimisht se: “1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij. 2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t'u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.”, ndërsa në nenin 18 të kësaj Konvente parashikohet

se: “Kufizimet e lejuara sipas kësaj Konvente ndaj të drejtave dhe lirive të sipërpërmendura nuk do të zbatohen për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë parashikuar.”.

Në çështjen “Kudrevious dhe të tjere kundër Lituanië” Dhoma e Madhe e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, më datë 27 Janar 2015, ka evidentuar kushtet që duhet të plotësojë një tubim që të konsiderohet paqësor, e për rrjedhojë të gëzojë mbrojtje sipas nenit 11 të KEDNJ-së.

Në këtë vendim ndër të tjera thuhet se: “Gjykata duhet të përcaktojë nëse faktet e çështjes konkrete përfshihen brenda fushës së veprimit të Nenit 11 të Konventës. Ajo rithekson se e drejta për lirinë e tubimit është një e drejtë themelore në një shoqëri demokratike dhe, njësoj si liria e shprehjes, është një nga themelet e një shoqërie të tillë. Kështu, nuk duhet interpretuar në mënyrë të kufizuar (shih Taranenko k. Ruisë, nr. 19554/05, § 65, 15 Maj 2014). Duke qenë se kjo e drejtë mbulon si tubimet në vendet private dhe publike, qoftë në një formë statike apo në formën e një marshimi, veç kësaj, mund të ushtrohet nga pjesëmarrës individualë dhe nga persona që organizojnë protestën (shih Djavit An k. Turqisë, nr. 20652/92, § 56, ECHR 2003-III; Ziliberberg k. Moldavisë (dec.), nr. 61821/00, 4 Maj 2004; dhe Barraco k. Francës, nr. 31684/05, § 41, 5 March 2009).

Neni 11 i Konventës mbron vetëm të drejtën për “tubimet paqësore”, një nocion që nuk përfshin një demonstratë, ku organizatorët dhe pjesëmarrësit kanë qëllime të dhunshme (shih Stankov dhe Organizata e Bashkuar Maqedonase Ilinden K. Bullgarisë, nr. 29221/95 dhe 29225/95, § 77, GJEDNJ 2001-IX). Garancitë e nenit 11, pra zbatohen për të gjitha tubimet, përveç atyre ku organizatorët dhe pjesëmarrësit kanë qëllime të tilla, nxisin dhunë ose nga ana tjetër kundërshtojnë themelet e një shoqërie demokratike (shih Sergey Kuznetsov k. Ruisë, nr. 10877/04, § 45, 23 tetor 2008; Alekseyev k. Ruisë, nr. 4916/07, 25924/08 dhe 14599/09, § 80, 21 tetor 2010; Faber, cituar më lart, § 37; Gun dhe të tjerë k. Turqisë, nr 8029/07, § 49, 18 qershor 2013; dhe Taranenko, cituar më lart, § 66).

Në çështjen në fjalë, gjykatat Lituanëze konkluduan se disa nga fermerët kishin përdorur automjete, sidomos traktorë, për të bllokuar autostradat. Kjo gjë nuk është kundërshtuar nga kërkuesit. Megjithatë, mjetet në fjalë nuk u përdorën për të shkaktuar dëmtime trupore ndaj punonjësit të policisë apo ndonjë anëtar të publikut. Gjykata vëren se, në çështjen konkrete, çrregullimi i trafikut

nuk mund të konsiderohet si një efekt anësor i tubimit të mbajtur në një vend publik, por më tepër si rezultat i një veprimi të qëllimshëm nga ana e fermerëve, të cilët dëshironin për të tërhequr vëmendjen për problemet në sektorin e bujqësisë dhe të nxisnin qeverinë që të pranonin kërkesat e tyre (shih, për shembull, Barraco, cituar më lart, § 39, ku dënimi i kërkesit për pjesëmarrjen e tij në një operacion për ngadalësimin e trafikut, që konsistonte në postblloqe automjetesh nëpër disa korsitë të autostradës për të ngadalësuar trafikun, u konsiderua se përbën ndërhyrje në të drejtat e tij sipas Nenit 11; shih gjithashtu Lucas k. Mbretërisë së Bashkuar (dec.), nr. 39013/02, 18 mars 2003 lidhur me një demonstratë gjatë së cilës një rrugë publike u bllokua për të protestuar kundër mbajtjes së një nëndetëseje bërthamore, u konsiderua se përfshihej në kushtet e nenit 11; . Steel dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar, 23 shtator 1998 § 92, Raportet e gjykimeve dhe Vendimeve 1998- VII, ku Gjykata e ka konsideruar se pengesa fizike e aktiviteteve - një gjueti dhe ndërtimi i autostradës – të cilën kërkesi i parë dhe i dytë, respektivisht nuk e pranuan, përbënte shprehje të mendimit brenda kuptimit të nenit 10; dhe Drieman dhe të tjerë k. Norvegjisë (dec.), nr. 33678/96, 4 maj të vitit 2000, ku Gjykata procedonte në supozimin se nenet 10 dhe 11 mund të jenë bazë për aktivistët e Greenpeace të cilët kishin manovruar anijen në një mënyrë të tillë që të pengonte gjuetinë e balenave). Kjo gjendje mund të ketë implikime për çdo vlerësim të «domosdoshmërisë», që do bëhet në bazë të paragrafit të dytë të nenit 11. Gjykata nuk e konsideron se sjellja e dyshuar në demonstratë për të cilën kërkesit janë konsideruar përgjegjës ishte e një natyre dhe e një shkalle të tillë, sa për të hequr pjesëmarrjen e tyre në demonstratën nga fushëveprimi i mbrojtjes së të drejtës së lirisë së tubimit paqësor të parashikuar nga Neni 11 i Konventës. Gjykata gjithashtu vëren se Gjykata Rajonale e Kaunas ka pranuar se kërkesit gëzonin të drejtën e lirisë së shprehjes sipas nenit 10 të Konventës (shih paragrafin 53 më lart) dhe e konsideron se nuk ka asnjë tregues se ankuesit kanë minuar themelet e një shoqërie demokratike. Kjo është e mjaftueshme për Gjykatën që të arrijë në përfundimin se kërkesit kanë të drejtë që të bazohen në garancitë e Nenit 11, i cili është në këtë mënyrë i aplikueshëm në çështjen konkrete.

Gjykata do të përcaktojë nëse ka pasur ndërhyrje në të drejtën e kërkesve për lirinë e tubimit. Ajo rithekson se ndërhyrja nuk është e nevojshme të përbëjë një ndalim të plotë, ligjor apo de facto, por mund të konsistojë në disa masa të tjera të ndërmarra nga autoritetet. Termi “kufizime” në Nenin 11 § 2 duhet interpretuar sikur përfshin si masat e marra para ose gjatë një tubimi dhe këto, si masa të tilla ndëshkuese të ndërmarra më vonë (shih Ezëlin, cituar më lart,

§ 39; Kasparov dhe të tjerë k. Ruisë, nr. 21613/07, § 84, 3 tetor 2013; Primov dhe të tjerë, cituar më lartë, § 93; dhe Nemtsov, cituar më lartë, § 73). Për shembull, një ndalim fillestar mund të ketë një efekt frenues mbi personat që planifikojnë të marrin pjesë në një tubim dhe në këtë mënyrë përbën një ndërhyrje, edhe nëse tubimi vazhdon më pas pa pengesa nga ana e autoriteteve. Refuzimi për të lejuar një individ për të udhëtuar për qëllimin e marrjes pjesë në një protestë përbën ndërhyrje gjithashtu. Gjithashtu masat e marra nga autoritetet gjatë një tubimi, të tilla si shpërndarja e tubimit ose arrestimi i pjesëmarrësve, dhe dënimet e imponuara për pjesëmarrje në tubim (shih Kasparov dhe të tjerë, cituar më lart, § 84, me referenca të mëtejshme). Gjykata vëren se në çështjen konkrete kërkesit u lejuan që të ushtronin lirinë e tyre të tubimit paqësor të papenguar, jo vetëm në vendet e autorizuara por gjithashtu dhe kur protesta u zhvendos në autostradat publike, në tejkallim të autorizimit të dhënë. Në të vërtetë, tubimet, edhe kur protestuesit përdorën postblloqe, nuk u shpërndanë nga policia. Megjithatë, kërkesit më pas u dënuan për shkak të rolit të tyre në organizimin dhe vendosjen e postblloqeve gjatë pjesës së fundit të protestës. Siç u theksua dhe më lart, sjellja e tyre në këtë aspekt, edhe pse e dënueshme, nuk konsiderohet se kishte një karakter të dhunshëm. Gjykata është në këtë mënyrë e përgatitur që të pranojë se dënimi i kërkesve për pjesëmarrjen e tyre në protestë përbën ndërhyrje në të drejtën e tyre për lirinë e tubimit paqësor. Një ndërhyrje e tillë do të përbëjë shkelje të Nenit 11, vetëm nëse nuk është e “Parashikuar nga Ligji”, nuk ndjek një ose më shumë qëllime legjitime sipas paragrafit 2 dhe nuk është “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për arritjen e këtij qëllimi ose qëllimeve në fjalë (shih, mes çështjeve të tjera, Vyerentsov k. Ukrainës, nr. 20372/11, § 51, 11 prill 2013, dhe Nemtsov, cituar më lartë, § 72).

E drejta e lirisë së tubimit, një nga themelet e një shoqërie demokratike, është subjekt i një numri kufizimesh të cilët duhet të interpretohen ngushtësisht dhe nevoja për çdo kufizim duhet të ngrihet në mënyrë bindëse. Kur shqyrtohet nëse kufizimet në të drejtat dhe liritë e garantuara nga Konventa mund të konsiderohen si “të nevojshme në një shoqëri demokratike” shtetet kontraktuese gëzojnë një marzh të caktuar, por jo të pakufizuar vlerësimi (shih Barraco, cituar më lart, § 42).

Natyra dhe ashpërsia e dënimeve të imponuara janë gjithashtu faktorë që duhen marrë parasysh kur vlerësohet proporcionaliteti i një ndërhyrje në lidhje me qëllimin e ndjekur (shih Öztürk k. Turqisë [DHM], nr. 22479/93, § 70, ECHR 1999-VI; Rufi Osmani dhe të tjerë, vendim i cituar më lartë; dhe Gün dhe të

tjerë, cituar më lart, § 82). Kur sanksionet e imponuara mbi protestuesit kanë natyrë penale, ata kërkojnë justifikim të veçantë (shih Rai and Evans, vendim i cituar me lart). Një protestë paqësore nuk duhet, në parim, të bëhet subjekt i kërcënimit të një saksioni penal (shih Akgöl dhe Göl k. Turqisë, nr. 28495/06 and 28516/06, § 43, 17 maj 2011), dhe sidomos i heqjes së lirisë (shih Gün dhe të tjerë, cituar me lart, § 83). Kështu, Gjykata duhet të shqyrtojë në mënyrë të veçantë çështjet ku sanksionet e imponuara nga autoritet kombëtare për sjellje jo të dhunshme përfshijnë një dënim me burgim (shiko Taranenko, cituar me lart, § 87).

Në parim, nuk është në kundërshtim me frymën e Nenit 11 nëse, për arsye të rendit publik dhe sigurisë kombëtare, një palë e lartë kontraktuese kërkon që zhvillimi i tubimeve të jetë subjekt i një autorizimi (shih Oya Ataman, cituar më lartë, § 37; Bukta dhe të tjerë k. Hungarisë, nr. 25691/04, § 35, ECHR 2007-III; Balçık dhe të tjerë k. Turqisë, nr. 25/02, § 49, 29 nëntor 2007; Nurettin Aldemir dhe të tjerë k. Turqisë, nr. 32124/02, 32126/02, 32129/02, 32132/02, 32133/02, 32137/02 dhe 32138/02, § 42, 18 dhjetor 2007; Éva Molnár, cituar më lart, § 35; Karatepe dhe të tjerë k. Turqisë, nr. 33112/04, 36110/04, 40190/04, 41469/04 dhe 41471/04, § 46, 7 prill 2009; Skiba, vendimi i cituar më lart; Çelik v. Turkey (nr. 3), nr. 36487/07, § 90, 15 nëntor 2012; dhe armë dhe të tjerë, cituar më lart, §§ 73 dhe 80). Në të vërtetë, Gjykata ka konsideruar më parë se njoftimi, dhe madje procedurat e autorizimit, për një ngjarje publike normalisht nuk shkelin mbi thelbin e së drejtës në bazë të nenit 11 të Konventës për sa kohë që qëllimi i procedurës është që të lejojë autoritetet të marrin masa të arsyeshme dhe të përshtatshme për të garantuar zhvillimin normal të çdo tubimi, mbledhje apo grumbullimeve të tjera (shih Sergey Kuznetsov, cituar më lart, § 42, dhe Rai dhe Evans, vendimi i cituar më lart). Organizatorët e tubimeve publike duhet të veprojnë në përputhje me rregullat që rregullojnë këtë proces duke respektuar rregulloret në fuqi (shih Primov dhe të tjerë, cituar më lart, § 117). Njoftimi paraprak i shërben jo vetëm qëllimit të bashkërendimit të të drejtës së tubimit me të drejtat dhe interesat e ligjshëm (duke përfshirë lirinë e lëvizjes) të të tjerëve, por gjithashtu qëllimit të parandalimit të trazirave apo krimit. Megjithatë, rregulloret e kësaj natyre nuk përfaqësojnë një pengesë të fshehur për lirinë e tubimeve paqësore, siç është e mbrojtur nga Konventa (shiko Samüt Karabulut k. Turqisë, nr. 16999/04, § 35, 27 janar 2009, dhe Berladir dhe të tjerë, cituar më lartë, § 39). 149.

Liria për të marrë pjesë në një tubim paqësor është e një rëndësie të tillë që një person nuk mund të jetë subjekt i sanksionit - madje edhe me një dënim të ulët

*në shkallën e dënimeve disiplinore - për pjesëmarrje në një demonstratë e cila nuk ka qenë e ndaluar, për aq kohë sa ai person nuk ka kryer vetë ndonjë veprim të gabuar në një rast të tillë (shih Ezelin, cituar më lart, § 53; Galstyan, cituar më lart, § 115, dhe Barraco, cituar më lart, § 44).*

*Një situatë e paligjshme, si vendosja e postblloqeve pa autorizim paraprak, nuk e justifikon domosdoshmërisht një ndërhyrje në të drejtën e një personin për lirinë e tubimit (shih Cisse k. Francës, nr. 51346/99, § 50, ECHR 2002- III; Oya Ataman, cituar më lart, § 39; Barraco, cituar më lart, § 45; dhe Skiba, vendimi i cituar më lart). Ndërkohë që rregullat që rregullojnë tubimet publike, si p.sh sistemi i njoftimit paraprak, janë themelore për sjellje të qetë të demonstruesve publikë, duke qënë se ata lejojnë autoritetet që të minimizojnë çrregullimin e trafikut dhe të ndërmarrin masa sigurie zbatimi i tyre nuk mund të bëhet një qëllim në vetvete (shih Primov dhe të tjerë, cituar më lartë, § 118). Në veçanti, kur demonstruesit nuk angazhohen në akte dhune, është e rëndësishme për autoritetet publike që të tregojnë një shkallë të caktuar tolerance, drejt tubimeve paqësore nëse liria e tubimeve e garantuar nga Neni 11 i Konventës nuk është kufizuar në thelbin e saj (shih Oya Ataman, cituar më lartë, § 42; Bukta and Others, cituar më lartë, § 37; Nurettin Aldemir dhe të tjerë, cituar më lart, § 46; Ashughyan, cituar më lart, § 90; Éva Molnár, cituar më lart, § 36; Barraco, cituar më lart, § 43; Berladir dhe të tjerë, cituar më lart, § 38; Faber, cituar më lart, § 47; İzci k. Turqisë, nr. 42606/05, § 89, 23 korrik 2013; dhe Kasparov dhe të tjerë,, cituar më lart § 91).*

*Mungesa e një autorizimi paraprak dhe “paligjshmëria” pasuese e veprimit nuk i jep carte blanche autoriteteve; ata janë ende të kufizuar nga kërkesat e proporcionalitetit të nenit 11. Në këtë mënyrë, fillimisht, duhet përcaktuar pse demonstrata nuk u autorizua, se çfarë interesi publik ishte në rrezik dhe çfarë rreziqet u përfaqëson nga protesta. Metoda e përdorur nga policia për të dekurajuar protestuesit, duke i mbajtur ata në një vend të caktuar ose duke shpërndarë demonstratën është gjithashtu një faktor i rëndësishëm në vlerësimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes (shih Primov dhe të tjerë, cituar më sipër, § 119).*

***Çdo demonstrim në një vend publik mund të shkaktojë një nivel të caktuar çrregullimi të jetës së zakonshme, duke përfshirë ndërprerjen e trafikut (shih Barraco, cituar më lart, § 43; Disk dhe Kesk k. Turqisë, nr. 38676/08, § 29, 27 nëntor 2012 dhe İzci, cituar më lart, § 89). Ky fakt në vetvete nuk e justifikon një ndërhyrje në të drejtën e lirisë së tubimit (shih Berladir dhe të tjerë, cituar***

***më lart, § 38, dhe Gün and Others, cituar më lart, § 74), pasi është e rëndësishme për autoritetet publike që të tregojnë një shkallë të caktuar tolerance (shih Ashughyan, cituar më lart, § 90).***

*Në rastin e Bukta dhe të tjerë kundër Hungarisë, GJEDNJ konstatoi se Hungaria kishte shkelur nenin 11 të Konventës Evropiane, sepse policia kishte shpërndarë një tubim paqësor mbi arsytimin se ajo ishte mbajtur pa njoftim paraprak nga ana e organizatorëve. Sipas këtij vendimi, megjithëse policia po vepronte në bazë të Ligjit të Hungarisë për Çështjet e Kuvendit të vitit 1989, i cili kërkon që policia të informohet për një tubim të paktën tri ditë përpara dhe t'i japë policisë autoritetin për të shpërndarë një tubim që zhvillohet pa njoftim paraprak, GJEDNJ-ja vendosi që një vendim për të shpërndarë një tubim paqësor vetëm për shkak të dështimit të organizatorëve për të përmbushur një kërkesë për njoftim, pa ndonjë sjellje të paligjshme nga pjesëmarrësit, është një kufizim joproporcional në të drejtën për zhvillimin e një tubimi paqësor të parashikuar në nenin 11 të Konventës.*

*Shtetet jo vetëm që duhet të përmbahen nga zbatimi i kufizimeve të tërthorta të paarsyeshme mbi të drejtën për t'u mbledhur në mënyrë paqësore, por gjithashtu duhet të mbrojnë këtë të drejtë. Edhe pse objekti kryesor i Nenit 11 është që të mbrojnë individin nga ndërhyrja arbitrare nga autoritetet publike ndërmjet ushtrimit të të drejtave të mbrojtura (shih Associated Society of Locomotive Engineers and Firemen (ASLEF) k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 11002/05, § 37, 27 shkurt 2007 dhe Nemtsov, cituar më lart, § 72), mund të ketë, përveç kësaj, detyrime pozitive për të siguruar gëzimin efektiv të këtyre të drejtave (shih Djavit An, cituar më lart, § 57, Oya Ataman, cituar më lart, § 36, dhe Gün dhe të tjerë cituar më lart, § 72).*

Nga jurisprudenca e GJEDNJ-së të cituar më lartë lidhur me lirinë e tubimit, arrihet në këto përfundime:

- i) e drejta për lirinë e tubimit është një e drejtë themelore në një shoqëri demokratike dhe, njësoj si liria e shprehjes, është një nga themelet e një shoqërie të tillë. Liria e tubimit përfshin mbledhjet publike dhe private, marshimet, procesionet, demonstratat dhe protestat ku protestuesit refuzojnë të largohen derisa të jenë plotësuar kërkesat e tyre. Qëllimi mund të jetë politik, fetar ose shpirtëror, ose çdo qëllim tjetër; lidhur me qëllimin nuk është vënë asnjë kufizim, por çdo tubim duhet të jetë paqësor;



- ii) një individ nuk pushon së gëzuari të drejtën e tij për lirinë e shprehjes, si rezultat i dhunës sporadike ose akteve të tjera të dënueshme të kryera nga të tjerët, në demonstratë, nëse individ i në fjalë vazhdon të mbajë një qëndrim paqësor në qëllimet e tij ose të saj. Mundësia që personat me qëllime të dhunshme, të cilët nuk janë anëtarë të shoqatave të organizuara, që marrin pjesë në demonstratë, nuk mund që si të tillë t'ua heqin të tjerëve këtë të drejtë. Edhe nëse ekziston një rrezik real se një demonstratë publike mund të rezultojë në një trazirë, si rezultat i zhvillimeve jashtë kontrollit të atyre që organizojnë protestën, një demonstratë e tillë nuk mund që për këtë shkak të mos përfshihet brenda fushëveprimit të Nenit 11. Pra, dhuna e rastësishme nuk do të thotë që tubimi e humbet mbrotjen, në përjashtim të rasteve kur ai ka qëllim përçarës;
- iii) Termi “kufizime” në nenin 11 § 2 të KEDNJ-së duhet interpretuar sikur përfshin si masat e marra para ose gjatë një tubimi dhe këto, si masa të tilla ndëshkuese të ndërmarra më vonë. Për shembull, një ndalim fillestar mund të ketë një efekt frenues mbi personat që planifikojnë të marrin pjesë në një tubim dhe në këtë mënyrë përbën një ndërhyrje, edhe nëse tubimi vazhdon më pas pa pengesa nga ana e autoriteteve. Refuzimi për të lejuar një individ për të udhëtuar për qëllimin e marrjes pjesë në një protestë përbën ndërhyrje gjithashtu. Gjithashtu masat e marra nga autoritetet gjatë një tubimi, të tilla si shpërndarja e tubimit ose arrestimi i pjesëmarrësve, dhe dënimet e imponuara për pjesëmarrje në tubim;
- iv) Njoftimi paraprak për organizimin e tubimit nga ana e organizatorëve i shërben jo vetëm qëllimit të bashkërendimit të të drejtës së tubimit me të drejtat dhe interesat e ligjshëm (duke përfshirë lirinë e lëvizjes) të të tjerëve, por gjithashtu qëllimit të parandalimit të trazirave apo krimit. Në mënyrë që të balancohen këto interesa në konflikt, njoftimi i institucionit të procedurave administrative paraprake paraqitet si një praktikë e zakonshme në shtetet anëtare kur do të zhvillohet një demonstratë publike. Megjithatë, mungesa e një autorizimi paraprak dhe “paligjshmëria” pasuese e veprimit nuk i jep të drejtë autoriteteve të shpërndajnë një protest.
- v) Çdo demonstrim në një vend publik mund të shkaktojë një nivel të caktuar çrregullimi të jetës së zakonshme, duke përfshirë ndërprerjen e trafikut. Ky fakt nuk e justifikon një ndërhyrje në të

drejtën e lirisë së tubimit, pasi është e rëndësishme për autoritetet publike që të tregojnë një shkallë të caktuar tolerance. Autoritetet duhet të jenë të kujdesshme të sigurohen që kufizimet të mos jenë diskriminuese. Fakti që organizatorët janë grup jo i pëlqyer individësh nuk përbën arsye të mjaftueshme për të ndaluar tubimin.

- vi) Arrestimi dhe burgosja e organizatorëve dhe pjesëmarrësve në kuadrin e një tubimi politik të organizuar nga partitë opozitare nuk është i justifikueshëm, qoftë dhe në një kohë të shkurtër, si dhe sjellë efekte negative. Kjo për faktin pasi sipas GJEDNJ-së këto masa kanë një impakt serioz dhe pengojnë përkrahësit e tjerë të opozitës dhe publikut të gjerë për të marrë pjesë në demonstrate dhe në përgjithësi, për të marrë pjesë në debat të hapur politik.

Parimet kushtetuese që garantojnë të drejtën e tubimit dhe interpretimet që i ka bërë kësaj të drejte GJEDNJ, kanë gjetur pasqyrim edhe në legjislacionin shqiptar.

Ligjit Nr.8773, datë 23.4.2001 “Për tubimet”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Në Republikën e Shqipërisë çdo person ka të drejtë të organizojë dhe të marrë pjesë në tubime paqësore dhe pa armë. 2. Kjo e drejtë kufizohet vetëm në rast se rrezikohet sigurimi kombëtar, sigurimi publik, mbrojtja e rendit dhe parandalimi i krimit, ruajtja e shëndetit ose moralit, ose mbrojtja e të drejtave dhe e lirive të tjerëve.”*

Në nenin 2 të këtij ligji nën titullin “Përkufizime” parashikohet shprehimisht se: *“Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1. “Organizator” kuptohet personi që organizon tubimin dhe persona të tjerë që japin ndihmesë në zhvillimin e tij. 2. “Person ndihmës për mbarëvajtjen e tubimit” kuptohet personi që mbështet organizatorin dhe drejtuesin e tubimit. 3. “Sheshe dhe vendkalime publike” kuptohen sheshet, bulevardet, rrugët dhe çdo mjedis tjetër që shfrytëzohet lirisht për lëvizjen dhe qëndrimin e çdo individi. 4. “Shef i Komisarariatit të Policisë” është shefi i komisarariatit të policisë në territorin në të cilin zhvillohet tubimi. 5. “Tubime” kuptohen grumbullimet, manifestimet, mbledhjet dhe parakalimet me karakter paqësor dhe pa armë, në të cilat një grup personash shprehin kërkesat dhe pikëpamjet e tyre për probleme për të cilat janë të interesuar dhe përfshin edhe tubimet urgjente. Kur grupe njerëzish grumbullohen në mënyrë spontane dhe nuk cenojnë rendin publik, veprimtaria e tyre nuk përfshihet në përkufizimin e tubimit. 6. “Vend i hapur për publikun”*

*është një vend në dispozicion të personave të tjerë, të cilët mund të vënë kushte për të lejuar ose jo hyrjen në të.”.*

Gjithashtu, në nenin 3 të këtij ligji nën titullin “Detyrat e Policisë së Shtetit” parashikohet shprehimisht se: *“1. Policia e Shtetit garanton dhe mbron të drejtën e çdo personi për të organizuar dhe marrë pjesë në tubime paqësore dhe pa armë. Ndalimi ose shpërndarja e një tubimi lejohet vetëm në rastet e parashikuara në këtë ligj. 2. Në çdo rast, zbatimi i masave për ndalimin dhe shpërndarjen e një tubimi paqësor e pa armë bëhet në mënyrë të shkallëzuar.”.* Nga përmbajtja e këtyre dispozitave, vendoset detyrimi pozitiv i shtetit për të garantuar dhe mbrojtur të drejtën e çdo personi për të organizuar dhe marrë pjesë në tubime paqësore dhe pa armë.

Më tej në Kreun II të Ligjit Nr.8773, datë 23.4.2001 “Për tubimet” është parashikuar procedura e tubimeve në sheshe dhe vendkalime publike. Kështu, në nenin 5 të këtij ligji nën titullin “Njoftimi i Policisë së Shtetit” parashikohet shprehimisht se: *“1. Në rast tubimi në sheshe ose vendkalime publike, organizatori dhe drejtuesi janë të detyruar të njoftojnë me shkrim shefin e komisarariatit të policisë jo më vonë se tri ditë para datës së zhvillimit të tubimit. 2. Njoftimi me shkrim duhet të përmbajë: a) identitetin dhe adresën e drejtuesit dhe të organizatorit të tubimit; b) qëllimin e tubimit; c) datën, vendin, orën e fillimit dhe të përfundimit të tubimit dhe itinerarin e tij (nëse ka të tillë); ç) numrin e përafërt të pjesëmarrësve dhe numrin e personave ndihmës në mbarëvajtjen e tubimit; d) personat që do të flasin në tubim. 3. Në rast se njoftimi me shkrim nuk i përmban elementet e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, ai i kthehet për plotësim organizatorit dhe drejtuesit të tubimit, të cilët duhet ta riparaqesin atë të plotësuar jo më vonë se 24 orë para kohës kur do të zhvillohet tubimi.”,* ndërsa në nenin 6 të këtij ligji, nën titullin “Detyrimi i policisë” parashikohet shprehimisht se: *“1. Shefi i Komisarariatit të Policisë, brenda 24 orëve nga marrja e kërkesës sipas pikës 2 të nenit 5 ose brenda 8 orëve nga marrja e kërkesës sipas pikës 3 të nenit 5 të këtij ligji, me vendim të arsyetuar duhet: a) t’i komunikojë organizatorit ose drejtuesit të tubimit ndalimet dhe kufizimet e mundshme ose kushtet e tjera, duke përfshirë edhe numrin e personave që do të ndihmojnë në mbarëvajtjen e tij; b) t’u japë një kopje të urdhrin zyrtar për caktimin e oficerit të policisë që do të jetë përgjegjës për të ndihmuar e vëzhguar zhvillimin e tubimit. 2. Shefi i Komisarariatit të Policisë njofton me shkrim drejtuesin e pushtetit vendor dhe prefektin për zhvillimin e tubimit.”.* Gjithashtu, në nenin 7 të këtij ligji nën titullin “Tubimet urgjente” parashikohet shprehimisht se: *“Kur ka rrethana urgjente, tubimi*

mund të zhvillohet pa respektuar afatin e parashikuar në nenin 5 të këtij ligji, po detyrimisht duhet të bëhet njoftimi me shkrim i cili përmban elementet e përcaktuara në nenin 5 pika 2 të këtij ligji, si dhe arsyen e urgjencës. Njoftimi duhet të bëhet menjëherë, po jo më vonë së 3 orë përpara kohës së zhvillimit të tubimit.”.

**Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se tashmë e drejta e tubimit, nuk i nënshtrohet asnjë formaliteti “për miratim nga organet e policisë”, sikurse parashikohej në ligjin e mëparshëm nr. 8145, datë 11.9.1996 "Për të drejtën e tubimeve", i cili është shfuqizuar tashmë, ku duhej të paraqitej detyrimisht kërkesa me shkrim për leje e cila miratohej ose refuzohej më pas nga shefi i komisarariatit të policisë. Për ushtrimin e kësaj të drejte tashmë kërkohet vetëm bërja e “njoftimit” në një kohë të përcaktuar i organeve të policisë ku të pasqyrohen disa të dhëna që lidhen me zbatimin e detyrës së saj si garantuese e ushtrimit të kësaj të drejte duke i dhënë kohe për të marrë masat e nevojshme për mbarëvajtjen e tubimit. Madje ligji aktual në nenin 7 parashikon edhe të drejtën e shtetasve për zhvillimin e tubimeve urgjente në rastet kur ka rrethana urgjente, i cili mund të zhvillohet pa respektuar afatin e parashikuar në nenin 5 të këtij ligji, por detyrimisht duhet të bëhet njoftimi me shkrim i cili përmban elementët e përcaktuar në nenin 5, pika 2 të këtij ligji, si dhe arsyen e urgjencës. Në këto raste njoftimi duhet të bëhet menjëherë, po jo më vonë së 3 orë përpara kohës së zhvillimit të tubimit.**

Fakti që në ligjin aktual përdoret termi “njoftim” drejtuar Komisarariatit të Policisë për zhvillimin tubimit dhe jo kërkesë është me shumë rëndësi dhe domethënës në favor të ushtrimit dhe garantimit të kësaj të drejte/lirie nga shtetasit. Nëse në këtë ligj do të parashikohej termi “kërkesë për zhvillimin e tubimit”, kuptohet në mënyrë të qartë se për të bërë të mundur ushtrimin e kësaj të drejte/lirie do të duhej miratimi i organit të policisë, sikurse ishte në ligjin e mëparshëm. Ndërsa **përdorimi në ligj i termin “njoftim”, do të thotë që “vendimin” për ushtrimin e të drejtës e ka marrë vetë subjekti njoftues nëpërmjet drejtuesit të tubimit dhe nuk kërkohet miratimi i organit të policisë.** Pikërisht këtu qëndron ndryshimi thelbësor që ka sjellë ligji i ri “Për tubimet” për të garantuar ushtrimin real të kësaj të drejte/lirie themelore kushtetuese të shtetasve në një vend demokratik.

Fryma pozitive e ligjit aktual reflektohet në mënyrë të qartë edhe në nenin 12 të tij, ku parashikohet zhvillimi i tubimeve në vendet e hapura për publikun pa bërë njoftimin paraprak të policisë sipas nenit 5 të tij. Përveç dispozitave të

cituara më sipër, duke i referuar nenit 15/2 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”*, organet shtetërore duke të kontribuojnë në realizimin e kësaj të drejte. Me Ligjin Nr. Nr.8773, datë 23.4.2001 “Për tubimet”, policisë nuk i njihet më e drejta për të dhënë leje për zhvillimin e një tubimi, por ka vetëm kompetencë të bëjë ndalimin dhe shpërndarjen e tubimit apo largimin e një grupi personash nga tubimi që pengojnë zhvillimin normal të tij. Kështu, në nenin 8 të këtij ligji nën titullin “Ndalimi i zhvillimit të një tubimi” parashikohet shprehimisht se: *“Kur ka arsye të motivuar se zhvillimi i një tubimi në një shesh ose vendkalim publik përbën një rrezik real për sigurinë kombëtare, sigurinë publike, parandalimin e krimit, mbrojtjen e shëndetit ose të moralit ose mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të të tjerëve dhe ky rrezik nuk mund të ndalohet me masa më pak shtrënguese, shefi i komisarariatit të policisë mund të ndalojë zhvillimin e tubimit ose të vendosë për kohën dhe vendin e zhvillimit të tubimit.”*, ndërsa në nenin 9 të këtij ligji nën titullin “Shpërndarja e një tubimi” parashikohet shprehimisht se: *“1. Një tubim në një shesh ose vendkalim publik mund të shpërndahet nga forcat policore me uniformë, vetëm në rastet kur: a) mënyra e zhvillimit të tubimit është e tillë që mund të dëmtojë në mënyrë konkrete rendin publik dhe sigurinë e personave; b) gjatë zhvillimit të tij kryhen krime; c) ekziston një situatë emergjente që lidhet me sigurinë publike, kur vendi i zënë nga tubimi kërkohet nga shërbimet e emergjencës. 2. Oficeri i policisë, përgjegjës për të ndihmuar dhe vëzhguar zhvillimin e tubimit, mund të urdhërojë largimin e një grupi personash nga tubimi, në rast se mendon se rreziku shmanget me largimin e këtij grupi personash që pengojnë zhvillimin normal të tubimit. Në rast të kundërt, oficeri i policisë, përgjegjës për të ndihmuar dhe vëzhguar tubimin, urdhëron organizatorët, drejtuesit dhe pjesëmarrësit të ndërpresin tubimin dhe të largohen nga vendi.”*.

Marrja paraprakisht e lejes për tubim ka qenë kërkesë ligjore e një ligji që tashmë është shfuqizuar dhe nuk është në përputhje me evoluimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së. Edhe nëse nuk do të bëhej një njoftim formal me shkrim për zhvillimin e tubimit, përsëri nuk jemi përpara një veprë penale sepse mosnjoftimi me shkrim nuk e bën një tubim të paligjshëm sikurse theksohet nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, e cila prevalon mbi ligjet e vendit. Kjo për faktin pasi tubimi mund të jetë paqësor edhe pse nuk është bërë njoftim formal për zhvillimin e tij.

Bazuar në sa më sipër, veprimet e Policisë së Shtetit, të datës 11.10.2019, për heqjen e lirisë së shtetasve, nëpërmjet shoqërimit apo arrestimit, vetëm për faktin e pjesëmarrjes në një tubim, të njoftuar rregullisht, madje në disa raste edhe për shkak të profesionit (rasti i operatorit), përbëjnë vepër penale të parashikuar nga nenet 248, 250, 251 dhe 261 të Kodit Penal. Këto veprime të kundërligjshme të Policisë së Shtetit synojnë pengimin e një të drejtë themelore të njeriut – të drejtës së tubimit, duke rrezikuar në këtë mënyrë cenimin e parimeve themelore të një shteti demokratik.

Këto vepra penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Shtetit duhet të hetohet në mënyrë të menjëhershme nga ana e Prokurorisë e cila pasi të administrojë provat filmike dhe të identifikojë autoret e kryerjes së këtyre veprave, duhet të vendosi sa më parë masa shtrënguese personale, duke i pezulluar ata edhe nga cdo funksion publik deri në përfundim të hetimeve, si dhe duke regjistruar procedim penal ndaj tyre. Kjo kërkesë bëhet dhe për faktin që këto veprime nga ana e Policisë së Shtetit janë të vazhdueshme ndaj qytetarëve të Republikës së Shqipërisë edhe në nderhyrje apo raste të tjera në të shkuarën.

Për sa më sipër, në zbatim të dispozitave të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale, kërkojmë hetimin dhe dënimin e personave përgjegjës, për kryerjen e veprave penale të parashikuara në objektin e këtij Kallëzimi.

Duke ju uruar punë të mbarë,

**PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË**

Përfaqësuar nga:

**GAZMENT BARDHI**

**Sekretar i Përgjithshëm**